



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr.6, datë, 22.02.2023

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME
DURRËS SH.A.**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence*" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "*Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 22.02.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin e shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a.",

Konstaton se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a me shkresën nr.554 prot. datë 30.01.2022, me lëndë "Kërkesë për pajisje me licence" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për licencim.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (**VKM nr. 302**).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:
- a) Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a (NUIS M22031502M) është themeluar më datë 13.07.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, Bashkitë Durrës me 32.47%, Shijak me 2.43%, Rrogozhinë me 2.16%, Krujë me 3.45%, Kavajë me 8.49%.
 - b) Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 472,148 banorë të Bashkive Durrës, Shijak, Rrogozhinë, Krujë, Kavajë;
 - c) Drejtues teknik i shoqërisë Z. Gerald Dautaj është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me Master Shkencor në Hidroteknik, në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
 - d) Drejtues teknik i shoqërisë Z. Bledar Metalla është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me Master Shkencor në Hidroteknik, në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
 - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Durrës sh.a është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a me (NUIS M22031502M), në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria B - Për përpunimin e ujit për konsumim publik,
 - c) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura,
 - d) Kategoria D - Për përpunimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues Ligjor – Spartak Kovaçi
 - b) Drejtues Teknik – Gerald Dautaj
 - c) Drejtues Teknik – Bledar Metalla
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a janë Bashkitë Durrës, Shijak, Rogozhinë, Krujë, Kavajë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Teknike Ekonomike të njoftojë shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a për marrjen e këtij vendimi.
7. Vendimi i KKRR nr.344, datë 23.09.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR nr.272 date 30.03.2021 për “Licencimin e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Krujë sh.a”, shfuqizohet;.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Ndriçim Shani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 14, datë 16.05.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 6, DATË 22.02.2023 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 16.05.2024 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 6, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës”

Vëren se:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës me shkresën nr. 1338 prot. datë 19.03.2024 me lëndë: “Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit teknik dhe ligjor”, plotësimet me shkresën nr. 1338/2 prot. datë 22.04.2024 me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e të dhënave në Licencën e Shoqërisë Rajonale Durrës sh.a” si dhe ndryshimet me shkresën nr. 1338/3 prot. datë 10.05.2024 me lëndë: “Kërkesë për ndryshimin e të dhënave në licencën e SHRUKD sh.a.”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura

(**ERRU**) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor dhe një nga drejtuesit teknik të shoqërisë të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, e ndryshuar;

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit, e ndryshuar.
3. **KKRR** ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës me vendimin nr. 6, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtues ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës z. Sedi Çausi është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me Master Shkencor në Hidroteknik, në vitin 2015;
5. Drejtues teknik i shoqërisë Z. Gerald Dautaj është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me Master Shkencor në Hidroteknik, në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
6. Drejtues i dytë teknik i shoqërisë z. Tonin Doda me titull Inxhinier Markshajder është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti Gjeologji - Miniera, Dega Miniera (Specialitet i Markshajderit) në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;
7. **ERRU** në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958, dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efijencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pika 2 a) dhe 2 c) e vendimit të KKRR nr. 6, datë 22.02.2023 “Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës ” ndryshojnë si më poshtë:

- a) Drejtues Ligjor z. Sedi Çausi
- c) Drejtues Teknik z. Tonin Doda

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani